



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1083 Prot.

Roskovec, më 20.02.2024

VENDIM

NR. 11 DATË 19.02.2024

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERSIMIT DHE PARASHIKIMIT  
AFATMESEM TË TË ARDHURAVE 2025-2027”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar, Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,Ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”,Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,Ligjit Nr. 9975 datë 28.07.2008, “Për Taksat Kombëtare”, Udhëzimet përkatëse për parashikimin afatmesëm 10/1 datë 28.02.2017, 10/2 datë 13.07.2017, V.K.M. Nr. 132 datë 07.03.2018 “Për metodologjin për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë të paluajtshme ndërtesa”,Udhëzimi Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedura standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, neni 59 dhe neni 60,Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dokumentit “Raport vlersimi dhe parashikimi afatmesëm të të ardhurave 2025-2027” sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore për zbatimin e këtij vendimi .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Blaka



---

**RAPORT PËR VLERSIMIN DHE  
PARASHIKIMIN AFATMESEM TË TË  
ARDHURAVE 2025-2027**

**I. Legjislacioni mbi të cilin është mbështetur hartimi i parashikimit afatmesëm i të ardhurave 2025-2027**

Misioni i këtij buxheti ashtu si dhe gjithë buxhetet e hartuar edhe më parë nga Bashkia Roskovec është të jetë gjithpërfshirës, i paanshëm, perceptues, transparent, por **mbi të gjitha është të jetë i ligjshëm.**

Në këtë kuadër hartimi i parashikimit afatmesëm i të ardhurave është përgatitur në mbështetje të ligjit.

- a) Ligjit nr.115/2014 datë 31.07.2014 "Për ndarjen Administrative Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë"ndryshuar.
- b) Ligjit Nr 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- c) Ligjit Nr 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- d) Ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
- e) Nr. 68/2017 Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore .
- f) Ligjit nr 9936 datë 26.06.2008 "për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
- g) Ligjit nr 9975 datë 28.07.2008, "Për Taksat Kombëtare"
- h) Udhëzimet përkatëse për parashikimin afatmesëm 10/1 datë 28.02.2017, 10/2 datë 13.07.2017, V.K.M. Nr. 132 datë 07.03.2018 "Për metodologjin për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë tëpaluajtshme ndërtesa".
- i) Udhëzimi nr. 23. Date 30.07.2018 "Për procedura standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore", neni 59 dhe neni 60.

Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve janë mbështetur në nenin 34 të ligjit nr.68/2017 " Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" në të cilin thuhet se:

Raport për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për:

- a) nje vite para vitit buxhetor koherent;
- b) vitin buxhetor;
- c) tre vitet e ardhshme buxhetore.

2. Në këtë raport përfshihen:

- a) metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave;
- b) analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose të ndryshimit të atyre ekzistuese;
- c) analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre

### **1. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR PARASHIKIMIN AFATMESËM TË TË ARDHURAVE 2025 - 2027**

#### **Politikat tatimore dhe parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme**

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Roskovec është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, informacion i përfituar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në një vite para si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore për to.

Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat, që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për kete periudhe afatmesme reflekton dhe ndryshimet në paketën fiskale si dhe parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve.

Në këtë parashikim janë marrë në konsideratë:

- Rritja të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve( familjare dhe biznese) dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe regjistrimi i atyre të reja);
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet;
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse &tarife, për të evidentuar faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.

### Ecuria e të ardhurave dhe parashikimi për tre vitet të tjera buxhetore

		Ne mijë/ leke				
	<i>BURIMET E FINANCIMIT</i>	Fakti i vitit 2023	I pritshmi i vitit 2024	Parashikimi per vitin 2025	Parashikimi per vitin 2026	Parashikimi per vitin 2027
1	<i>Të ardhurat lokale</i>	251,492	371,491	385,069	385,069	385,069
2	<i>Transferta të pakushtezuara te pergjithshme</i>	147,607	148,096	156,982	167,971	167,971
3	<i>Transferta të pakushtezuara sektoriale</i>	67,249	83,825	84,663	85,509	85,509
	<i>Të ardhurat gjithesej</i>	466,348	603,412	626,714	638,549	638,549

#### A. Të ardhurat e veta vendore

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave të vet „me përjashtim të transfertës së kushtëzuar.Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të percaktuara nga ligji 139/2015“ Për veteqeverisjen vendore ”. Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal. Pra, pjesë përbërëse e këtyre të ardhurave janë dhe ato që trashëgohen nga viti i mëparshëm. Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Roskovec referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak për vitin 2024, Nr.101 datë 30.11.2023 si dhe miratimin e Prefektures me Nr.Prot. 1238/1 datë 14.12.2023“ Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2024” e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit,kohën e kryerjes së tyre,kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse përvjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

*Bashkia Roskovec*

Paketa fiskale 2024 përcakton :

- a) Kornizën ligjore për përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese;
- b) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësiive për çdo taksë dhe tarifë.
- c) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen e taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë është detajuar duke patur në konsideratë elementët:
  - ✓ Klasifikimi biznesit, qarkullim vjetor, lloj i aktivitetit;
  - ✓ Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;
- h) Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon, përcaktimin dhe detajimin në kategori, unifikimin e kategorive për të gjitha taksat, përcaktimin e bazës së taksueshme dhe aplikimin e kufijeve që përcakton ligji.
- i) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësi, përcaktimin dhe detajimin në kategori, unifikimin e kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimin e nivelit të tarifave mbështetur në raportet bazë të vlerësimit të kostos së shërbimit për të cilin vendosen (shërbimi i pastrimit, shërbimi i ndriçimit rrugor, shërbimi gjelberimit);
- j) Aplikimin e iniciativave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, referuar legjilacionit në fuqi.

**Tabela 1 Të ardhurat nga burimet lokale dhe burimet qendrore**

Treguesit janë paraqitur për një vit para vitit buxhetor, vitin buxhetor, parashikimi për tre vitet e ardhshme.

Në mijë/lekë

EMERTIMI I BURIMEVE FINANCIARE	Fakti vitit 2023	I pritshmi Viti 2024	Parashikim Viti 2025	Parashikim Viti 2026	Parashikim vitit 2027
Transferta e Pakushtëzuar e përgjithshme	147,607	148,096	156,982	167,971	167,971
Te ardhurat Lokale	251,492	371,491	385,069	385,069	385,069
Transferta e Pakushtëzuar sektoriale	67,249	83,825	84,663	85,509	85,509
<b>TOTALI</b>	<b>466,348</b>	<b>603,412</b>	<b>626,714</b>	<b>638,549</b>	<b>638,549</b>

### A.1 Të ardhurat nga burime te veta vendore sipas llojit

Të ardhurat nga burime te veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifatat, të ardhurat nga shitja e pronave, të ardhura nga dhënia me qera e tokës bujqësore, truallit apo edhe dhënia me qera e aseteve të saj (Ndertesa), si dhe të ardhurat nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat në masën 64% për vitin 2024, në masën 62.5%, për vitin 2025, 62.5% për vitin 2026 dhe 62.5% për vitin 2027.

Tarifatat përbëjnë 36% të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2024, 37.5%, për vitin 2025, dhe 37.5% për vitin 2026 dhe 37.5% për vitin 2027.

**Tabela 1. Të ardhurat nga burimet e veta vendore Buxheti afatmesëm 2025-2027**

Burimet	Në mijë/lekë			
	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
Te ardhurat nga Taksat	236,635	240,701	240,701	240,701
Te ardhurat nga tarifatat	130,454	139,766	139,766	139,766
Te ardhurat nga pronat dhe dhënia me qera e tyre	2,902	2,902	2,902	2,902
Te ardhura të tjera	1,500	1,700	1,700	1,700
<b>TOTAL</b>	<b>371,491</b>	<b>385,069</b>	<b>385,069</b>	<b>385,069</b>

Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2024 janë kryesisht taksa mbi pasurinë e paluajtshme (ndertesa, toka bujqësore dhe truall) që zë rreth 42%, taksa e Rentes Mincrare që zë 16%, dhe të ardhura nga tarifatat që zënë rreth 35%, këto janë zërat kryesor që mbulojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave të Bashkisë Roskovec.

Tabela mbi parashikimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore si dhe burimet e tjera që do të përbëjnë buxhetin afatmesem të të ardhurave në Bashkinë Roskovec.

Në 000 lekë

Emertimi i te ardhurave Tatimore	Fakti 2023	I pritshmi 2024	Parashikimi per vitin 2025	Parashikimi per vitin 2026	Parashikimi per vitin 2027
<b>Te ardhurat nga taksat</b>	209,870	236,635	240,704	240,704	240,704
Taksa mbi Ndertesat	121,416	125,020	125,020	125,020	125,020
Taksa mbi token bujqesore	22,755	26,978	25,852	25,852	25,852
Taksa e fjetesjes ne hotel	-	0	-	-	-
Taksa e ndikimit ne infrastruktur nga nd	3,662	5,500	5,500	5,500	5,500
Taksa e kalimit te drejtes se pronesis pe	-	100	100	100	100
Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	10,596	9,000	9,000	9,000	9,000
Taksa e tabelës	622	559	559	559	559
Taksa e rentes minerare	39,640	60,000	65,000	65,000	65,000
Taksa mbi truallin	2,534	2,478	2,670	2,670	2,670
Takse mbi te ardhurat personale	8,645	7,000	7,000	7,000	7,000
<b>Te ardhurat nga tarifa</b>	37,362	130,454	139,766	139,766	139,766
Tarifa per pastrimin	15,676	21,340	21,340	21,340	21,340
Tarife per ndricim rrugor	2,571	4,186	4,186	4,186	4,186
Tarife gjelberimi	2,472	4,186	4,186	4,186	4,186
Tarife per parkim	280	300	400	400	400
Tarife per vulosje veterinare te bagetiv	-	0	-	-	-
Tarife per dhenje leje licensa dhe auto	249	500	1,000	1,000	1,000
Tarifa per mirmbajtje vaditje kullim	6,551	7,798	7,700	7,700	7,700
Tarife zenie hapsire publike	2,893	3,835	3,324	3,324	3,324
<b>Te tjera jo tatimore</b>	6,670	88,309	97,630	97,630	97,630
<b>Te ardhura nga shitesja e prones dhe dhe</b>	2,857	2,902	2,902	2,902	2,902
Gera troje (toke)	2,657	2,902	2,902	2,902	2,902
Gera truall	-	-	-	-	-
<b>Te ardhura te tjera</b>	6,200	1,500	1,700	1,700	1,700
Te ardhura nga pagesat per kopeshite dl	1,603	1,500	1,700	1,700	1,700
Te ardhura te trashguara nga viti i kaluar	4,597	-	-	-	-
<b>Totali te ardhurave te veta (VI-VII)</b>	253,492	371,451	385,069	385,069	385,069
<b>Te ardhura Pakushtezuar</b>	214,856	231,921	241,645	253,480	253,480
Transferta të pakushtezuara te pergjith	147,607	148,096	156,982	167,971	167,971
Transferta të pakushtezuara sektoriale	67,249	83,825	84,663	85,509	85,509
Te ardhurat gjithesej (VI-VII)	468,348	603,412	626,714	638,549	638,549

### Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat për taksapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga këshilli i bashkisë.

Në total numri taksapaguesve është parashikuar rreth 8171 (familje 7650, biznes 495 edhe Institucione 26). Peshën numerike më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë familjet.

### Taksapaguesit familjarë

*Bashkia Roskovec*



## **Numri i familjeve taksapaguese**

Në total numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë Roskovec është 7650 familje. Nga keto familje, 1260 familje me ndihme ekonomike, invalid dhe pensioniste përfitojnë nga lehtësirat sipas vendimit të Këshillit bashkiak nr.101 datë 30.11.2023 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2024"

Parashikimi I të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafëruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arketimeve në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve sipas Regjistarve në drejtorinë e të ardhurave vendore.

Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësi fiskale për familjet me problem sociale, si për familjet që janë përfitues të ndihmës ekonomike, për pensionistët, për invalidët etj., të cilët përbëjnë rreth 16.5% të familjeve taksapaguese.

## **Taksapaguesit biznese dhe institucione**

Bazuar në regjistrat aktual, në total, numri i bizneseve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë është 495 dhe 26 institucione.

## **2. ANALIZA E TË ARDHURAVE TË VETA VENDORE DHE EFEKTET E POLITIKAVE TË REJA FISKALE OSE TË NDRYSHIMEVE TË TYRE**

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifat për shërbimet publike dhe të ardhura të tjera vendore.

Sipas ligjit 139/2015 "Për vetë-qeverisjen vendore", neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen dhe administrimin e tyre brenda kufijve sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Roskovec nr.101 datë 30.11.2023 "Për miratimin e Paketës Fiskale 2024" në Bashkinë Roskovec

### **A. Të ardhurat nga taksat vendore**

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësisë të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

*Bashkia Roskovec*

Paketa fiskale e bashkisë Roskovec për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh(juridik) dhe të vogël(fizik), banorëve të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë,

Për vitet 2025-2027 parashikohet që të ardhurat nga taksat të përbëjnë rreth 51- 63% të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë.

### **Analiza e parashikimit të të ardhurave për secilën taksë**

#### **a) Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme**

Këto të ardhura përfshijnë të ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat(mbi ndërtesat e banimit, ndërtesat ekonomike dhe mbi ndërtesat e tjera)
- Taksa mbi token bujqësore
- Taksa mbi truallin

#### **1.Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat**

Ligjit Nr 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar V.K.M. Nr. 132 datë 07.03.2018 "Për metodologjin për percaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë të paluajtshme ndërtesa"

Parashikimi për vitet 2025-2027 bazohet të zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimit dhe vlerësimit të drejtë të sipërfaqeve.
- Rritjes së efikasitetit me anë të implementimit të programeve të kompjuterizuar,
- Ndarjes në këste të pagesave për detyrimet e prapambetura

Të ardhurat nga taksa për ndërtesat për vitin 2024 parashikohen në vlerën 125,019,985 Lekë, për vitin 2025 me vlerën 125,019,985 lekë dhe për vitin 2026 me vlerë 125,019,985 lekë dhe për vitin 2027 me vlerë 125,019,985 lekë .

#### **2.Të ardhura nga Taksa mbi token bujqësore**

Baza e taksës është sipërfaqja e tokës bujqësore,në hektar,në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit.

Duke u krahasuar me reference ligjore,taksa e çdo kategorie e tokës bujqësore ka një lehtësim që shkon në maksimumin e lejuar ligjor prej 30%.

Planifikimi i të ardhurave bazohet mbi kapacitetin aktual fiskal të njësive administrative, mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nëpërmjet saktësimit të sipërfaqeve reale dhe kategorizimit të saktë dhe aktual të tokës bujqësore,si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite.Të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore për *Bashkia Roskovec*

vitin 2024 parashikohen në vlerën 26,978,066 Lekë,për vitin 2025 me vlerë 25,852,496 lekë dhe për vitin 2026 me vlerë 25,852,496 lekë dhe për vitin 2027 me vlerë 25,852,496 lekë .

### **3. Të ardhura nga Taksa mbi truallin**

Me "Truall" kuptohet një sipërfaqe toke,jo tokë bujqësore,që ndodhet Brenda vijës kufizuese të ndërtimit,e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit,të miratuar për të ndërtuar mbi të. Baza e taksës është sipërfaqja në meter katror.

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar në sipërfaqet aktuale të banesave dhe ndërtesave të tjera,dhe mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksa paguesve nëpërmjet saktësimit të sipërfaqeve.Të ardhurat nga taksa e truallit për vitin 2024 parashikohen në vlerën 2,477,853 Lekë, për vitin 2025 me vlerë 2,670,000 lekë per vitin 2026 me vlerë 2,670,000 lekë dhe per vitin 2027 me vlerë 2,670,000 lekë .

#### **b) Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja administrohet nga Bashkia Roskovec. Bazuar në ligjin 9632,taksa e ndikimit në infrastrusture për ndërtimet e reja përcaktohet në kufijtë 4-8% e çmimit të shitjes për ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik.

Sipas "Paketes Fiskale për vitin 2024" miratuar nga Këshilli Bashkise Roskovec me vendimi numer 101 date 30.11.2023, çmimi i shitjes për meter katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave",që miratohet çdo vit. Bazuar në Ligjin Nr.9482"Për legalizimin,urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje",taksa për ndërtesat në proces legalizimi llogaritet 0,5% e vlerës së investimit.

Parashikimi për taksën e ndikimit në infrastrusture bazohet mbi parashikimin e lejeve për ndërtimet e reja dhe shlyerjen e detyrimeve për objektet në proces legalizimi si dhe duke u bazuar ne realizimin e viti te kaluar.

Të ardhurat nga kjo taksë vitin 2024 parashikohen në vlerën 5,500,000 Lekë,për vitin 2025 me vlerë 5,500,000 Lekë dhe për vitin 2026 me vlerë 5,500,000lekë dhe për vitin 2027 me vlerë 5,500,000lekë .

#### **c) Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**

Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr.9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit,nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme,dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme,të cilat,në rolin e agentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar,ndërsa diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Roskovec jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Bashkia Roskovec

Parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë bëhet duke u bazuar në të ardhurat e viteve të kaluara. Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2024,2025,2026,2027 parashikohen në vlerën 100,000 mijë lekë për çdo vit.

#### **d) Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura**

Bazuar në ligjin 9975 dt.28.07.2008“Për Taksat Kombëtare”të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore në rolin e agjentëve tatimorë,një pjesë e këtyre të ardhurave transferohen në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë.

Referuar pikes 3,të Nenit 4 të Ligjit 9975,Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara,25% e të ardhurave nga kjo taksë kalon për llogari të Bashkisë Roskovec.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor referuar numrit të automjeteve si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara dhe referuar të dhënave për nivelet e arkëtimitve.Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2024 parashikohen në vlerën 9,000 000 Lekë, për vitin 2025 në vlerën 9,000,000 lekë dhe për vitin 2026 parashikojmë në vlerën 9,000,000 lekë, për vitin 2027 parashikojmë në vlerën 9,000,000 lekë .

#### **e) Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare**

Bazuar në nenin 4 I ligjit nr.9975,date 28.7.2008“Për Taksat Kombëtare”I ndryshuar,baza e taksës së rentës minerare llogaritet mbi burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik,në çastin kur ai shet produktin.Personi fizik apo juridik,që është I licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë,duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka.Renta minerare llogaritet si detyrim mujor I subjektit taksapagues,në çastin kur ai shet produkte minerare.Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare,ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente,në rastin e shitjes së produkteve minerare Brenda vendit,(5%)e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë I kalon përkatësisht Bashkisë Roskovec në llogarinë e degës së thesarit Fier.

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite.Të ardhurat nga kjo taksë vitin 2024 parashikohen në vlerën 60,000,000 Lekë,për vitin 2025 në vlerën 65,000,000 dhe në vitin 2026 në vlerën 65,000,000 lekë dhe për vitin 2027 në vlerën 65,000,000 lekë.

#### **f) Të ardhura nga Taksa e Tabelës**

Bazuar në Ligjin Nr.9632,dt.30.10.2006“Për sistemin e taksave vendore”,I ndryshuar taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash,të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

*Bashkia Roskovec*

**Tabela për qëllime identifikimi**, të cilat nëse janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose Brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2m<sup>2</sup> nuk taksohen.

**Tabela për qëllime reklamimi**, ku përfshihen tabelat që nuk janë Brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike.

**Tabela për qëllime ekspozimi**, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozime të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2024 parashikohen në vlerën 558,830 Lekë, për vitin 2025 me vlerë 558,830 mijë lekë, për vitin 2026 me vlerë 558,830 mijë lekë dhe për vitin 2027 me vlerë 558,830 mijë .

## **B. Të ardhurat nga Tarifat Vendore**

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetë qeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për shërbimet publike që ato ofrojnë, të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu Bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikën dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Paketa fiskale e Bashkisë Roskovec për vitin 2024 e miratuar në Keshillin e Bashkisë vendim nr. 101 date 30.11.2023 parashikon disa politika të rëndësishme lehtësuese apo ulje të niveleve nga ajo e llogaritur referuar kostos së shërbimit të ofruar. Disa prej tyre janë:

- Tarifa zero për familjet me ndihme ekonomike
- Tarifa zero për invalidet dhe veteranet.
- Tarifa të reduktuara 50% për kryefamiljaret pensioniste pa persona madhore në ngarkim dhe kryefamiljaret gra (te ve ose te divorcuara)

Pjesë e rëndësishme në këtë kategoritë të ardhurave nga tarifatat janë të ardhurat nga tarifatat për ofrimin e shërbimeve publike, si pastrimi i mbetjeve, gjelbërimi, ndriçimi, të cilat së bashku zënë pjesën më të lartë të ardhurave nga tarifatat vendore.

Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, kjo tarifë paguhet nga familjet, bizneset dhe institucionet të cilat kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim.

Ngarkesa e tarifimit është shpërndarë duke u bazuar:

- Në vendndodhjen (zone urbane apo zone rurale),
- në llojin e aktivitetit (tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë,

***Bashkia Roskovec***

- fermer, transport, ndërtim, karburant, institucion, ofj, etj)
- dhe në statusin e subjektit (familjar, biznes i madh, biznes i vogël, institucion shtetëror etj).

#### **Të ardhura nga burime të tjera**

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetë qeverisjen vendore", neni 36, të ardhura nga burime të tjera janë: të ardhurat nga dhënia me qera e aseteve në pronësi të bashkisë; të ardhurat nga investimet mbi kapitalet; të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të bler nga bashkia; të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi; të ardhurat nga partneritetet privat-publik.

Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, komisionet si agjent tatimor, ndihmat ose donacionet.

#### **Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë**

Te ky zë parashikohen të ardhurat nga qira të bazuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, date 8.6.2011 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontratat e tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar. Pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, i lirë funksional (jo nëndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit.

#### **Te ardhurat nga kundrvajtje administrative (nga gjobat)**

Gjobat bazohen në ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative":

Bazuar në Nenin 6.b, "Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me aktet e këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fusha të veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta".

Bazuar në Nenin 10, "Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte.

Ky zë parashikon të ardhurat nga gjopa për mos shlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjopa nga kontrole dhe inspektime tatimore, gjopa për kundrvajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake, nga Inspektoriat i Ndërtimit Vendor etj.

#### **Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve**

Sipas përcaktimeve ligjore janë të ardhura që përfshihen në zërin të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve. Aktivitet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/material të riciklueshëm, hiqen nga regjistri I aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazine dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

#### **Te ardhurat nga pagesat**

Të ardhurat nga pagesat për kopësht dhe çerdhe. Për parashikimin e të ardhurave në këtë zë jemi mbështetur nr. e fëmijëve që frekuentojnë kopështin, si dhe kuatën ditore të tyre e cila ka dalë sipas analizës së kostos për vitin 2024 parashikohet 1,500,000 leke për vitin 2025 parashikohet 1,700,000 leke, për vitin 2026 parashikohet 1,700,000 leke dhe për vitin 2027 në

*Bashkia Roskovec*

vlerën 1,700,000 leke .

### 3. ANALIZA E RISQEVE DHE MASAT PËR PËRBALLIMIN E TYRE

Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre referuar Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Ligji përmban koncepte dhe përgjegjësi të reja për menaxhimin e riskut në institucionet publike.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i vetëdijshëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eliminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrë efektive.

Strategjia e riskut përkufizohet si qasja e njësisë për menaxhimin e riskut e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë publike dhe më tej. Ajo përcakton mënyrën se si sillet njësia ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve. Për risqet që janë cilësuar më të lartat (më kritiket), duhet të hartohet një plan afat-gjatë veprimi.

Për realizimin e të ardhurave të veta vendore, njëkohësisht duke ruajtur tendencën për përmirësimin e politikave dhe strategjive incentivuese e zhvilluese të ekonomise lokale, është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut duke kaluar në këto etapa:

- a) Identifikimi i objektivave
- b) Identifikimi i risqeve të jashtme dhe të brendshme.
- c) Analiza dhe vlerësimi i çdo risku (sipas probabilitetit dhe impaktit).
- d) Marrja e masave të metejshme, për pakësimin apo reduktimin e riskut.
- e) Paraqitja e të gjithë konkluzioneve të arritura
- f) Krijimi i hartës së riskut, grupimi në bazë të impaktit dhe probabilitetit të ndodhjes së tyre, duke treguar në këtë mënyrë ato fusha të veprimtarisë së njësisë, ndaj të cilave duhet të tregohet vëmendje e veçantë.
- g) Monitorimi dhe raportimi.
- h) Hartimi i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë.

Objektivat janë planifikimi buxhetor, llogaritja, analizimi dhe kontabilizimi i burimeve financiare të të ardhurave të veta, ndjekja e politikave dhe strategjive sensibilizuese,

*Bashkia Roskovec*

mbështetese dhe zhvilluese për krijimin e të ardhurave, zbutjes së informalitetit, rritjes së konkurrencës së ndershme, si dhe administrimi i marrëdhëniet me taksapaguesit dhe shërbimi ndaj tij.

Konceptoi: *Orgesa Goga*

*Selman Çepele*

